



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1129/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Shpresa Gashi kandidate për asamblenë komunale në Skenderaj nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si të bazuara ankesat e Anr.1129/2013 e datës 03.12.2013 të parashtruar nga Shpresa Gashi kandidate për asamblenë komunale në Skenderaj nga PDK.

URDHËROHET, KQZ-ja që të rinumëroj fletëvotimet në Qendrën e Votimit (QV) 2103B, vetëm sa i përket kandidates së sipërshënuar dhe rezultati të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i, më datën 03.12.2013 ka pranuar ankesën me nr. Anr.1129/2013 e datës 03.12.2013 të parashtruar nga Shpresa Gashi kandidate për asamblenë komunale në Skenderaj nga PDK, në të cilën pretendohet se në bazë të rezultateve të KKZ të dërguara në zyrën e PDK-së ka pasur 257 vota, ndërsa kandidatet tjera kanë pasur vota më pak pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

Bazuar në nenin 6.3 të *“Rregullave dhe Procedurave”* të PZAP-it, në të cilin parashihet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”*. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat tjera të lëndës e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

- ankesa është e bazuar

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese shihet se ka pasur parregullsi në formularë. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 1129/2013 më datën 06.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani

